



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.955/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkritazi me ankesën e kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal në Viti, Shqipe Emini nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Viti, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtare të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 09.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar ankesa e kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë, Shqipe Emini, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Viti.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Viti, të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Viti, në Vendvotimet: 2601X/02R, 2633D/01R, 2608D/01D, 2629D/01D dhe 2607D/03D.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimeve si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 10.11.2017, nga Shqipe Emini kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Viti, nga radhët e PDK-së, me të cilën pretendon se ka pasur vjedhje votash, keqnumrim i qëllimshëm i votive, rinumrim i paqëllimshëm në Qendrën e rinumërimit në Fushë Kosovë. Më tej ka theksuar se, në vendvotimin 2601X/02R në Viti ka pasur dy vota, ndërsa pas rinumërimit asnjë votë, dhe në vendvotimin 2633D/01R, kundërkandidates i është shtuar një votë. Gjithashtu thekson se në vendvotimin 2629D/01D në Sllatinë të poshtme, nga 12 vota janë regjistruar vetëm 6 vota, si dhe në vendvotimin 2607D/03D Sllatinë e Epërme, votat e njërit kandidat i janë vjedhur duke i numëruar për kandidatin tjetër (i janë hequr kandidatit me nr.8 dhe i janë dhënë kandidatit me nr.11 me

qëllim favorizimi). Më tej ka shtuar se dëshmitarin do ta bëjë publik pas hapjes së kutisë së vendvotimit dhe rinumërimit të votave.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët për anëtarë të Kuvendit Komunal, në Viti të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në vendvotimet e cekura më lartë dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*

Nga sa u tha me sipër në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr. 955/2017 më datën 12.11.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.